



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:043955

Datë: 10.01.2024

Numri i dokumentit: 05171132

C.nr.2483/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Florian Krasniqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.K të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat F.M, me adresë në Rr. Agim Ramadani, objekti 300/6, Prishtinë, kundër të paditurave: Kompania e Sigurimeve “....” me seli në Prishtinë, dhe N.P.N. “....”, të cilën e përfaqëson avokat D.R, nga Kaçaniku, me adresë: “....”, me objekt të kontestit kompensimin e dëmit, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, me datë 22.12.2023 mori, ndërsa me datë 10.01.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit H.K, ashtu që DETYROHET e paditura e dytë N.P.N. “....”që paditësit në emër të dëmit të shkaktuar në incidentin e datës 11.04.2009, t’ia paguajë shumat si në vijim:

a. Në emër të dëmit material

- Për perkujdesje të personit të tretë, shumën prej1.800,00 euro;
- Për ushqim të përforcuar, shumën prej.....2.000,00 euro;
- Në emër të kompensimit për rentën e arritur, për periudhën nga data 11.04.2009 e deri me datën 31.07.2016, për 45% të zvogëlimit të aftësisë punuese, shumën prej.....16.165,50€;
- Në emër të kompensimit për të ardhmen në formë të rentës mujore për 45% të zvogëlimit të aftësisë punuese, prej datës 31.07.2016 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore nga 100,00€ në muaj, e cila paguhet më së largu deri me 10 të muajit vijues.

b. Në emër të dëmit jo material

- Për frikën e pësuar, shumën prej.....6.500,00 euro;
- Për shëmtim trupor, shumën prej.....3.500,00 euro;
- Për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej20.000,00 euro;
- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej.....8.000 euro;

- II. **DETYROHET** e paditura e dytë N.P.N. “...”, që paditësit shumat e aprovuara si më lartë t’ia paguajë me kamatë ligjore si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar, ndërsa për kërkesat në emër të rentës së arritur pas datës 19.12.2012 me kamatë ligjore prej 8% në vit, ashtu që për format e dëmit jo material kamata do të llogaritet nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, ndërsa për format e dëmit material nga dita e paraqitjes së padisë në Gjykatë (datë: 25.09.2009), e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- III. **REFUZOHET si e pabazuar** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, mbi shumat e gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë shumat e refuzuara si në vijim: për dhimbje trupore - fizike, shumën prej 2,000.00 euro, për frikën e pësuar shumën prej 1,500.00 euro, për shëmtim trupor shumën prej 3,500.00 euro, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 10,000.00, për përkujdesje të personit të tretë shumën prej 200,00 euro, në emër të rentës së arritur shumën prej 2,657.1 euro, ndërsa në tërësi shumën prej 1,100.00 euro të kërkuar në emër të rehabilitimit fizioterapeutik dhe klimatik.
- IV. **REFUZOHET** në tërësi si e pabazuar kërkesëpadija e paditësit në raport me të paditurën e parë Kompania e Sigurimeve “...”, me të cilën ka kërkuar që paditësit për dëmin e shkaktuar t’ia paguajë shumat si në pikën I, II dhe III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.
- V. **DETYROHET** e paditura e dytë N.P.N. “...”, që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 5,430.00 euro, brenda afatit prej 15 - pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm, ndërsa pjesa tjetër e kërkuar në emër të shpenzimeve të procedurës në shumën prej 2.028,00 euro refuzohet si e pabazuar.

A r s y e t i m

I. Padija dhe pretendimet e palëve

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar pranë kësaj Gjykate me date 25.09.2009 ka paraqitur padi ndaj të paditurave, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material dhe jo material. Në padi ka theksuar që, me datën 11.04.2009 gjatë betonimit të pllakës mbi katin e parë të objektit të dytë në projektin “...” në lagjen “...” në Prishtinë, ka ndodhur një fatkeqësi ku si pasojë e kësaj fatkeqësie paditësi – punëtor i kompanisë NPN G.A.P, nga Prishtina ka pësuar lëndime të rënda trupore. Tutje ka theksuar se automjeti shkaktar i fatkeqësisë ka qenë pronë e kompanisë NPN “...”, e cila në momentin e shkaktimit të fatkeqësisë ka qenë e siguruar tek e paditura e parë “...”, me seli në Prishtinë. Ka shtuar se si rezultat i kësaj fatkeqësie i

lënduari tani paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, frikë të intensitetit të lartë, frikë të intensitetit të mesëm, dhimbje të intensitetit posaçërisht të lartë, shëmtim, dhe si rezultat i kësaj fatkeqësie i' u ka zvogëluar aftësia për punë dhe jetë, për të njëjtin ka qenë i nevojshëm ushqimi i përforcuar, ndihma dhe kujdesi i personit të tretë, shërimi klimatik.

Në seanca gjyqësore dhe në fjalën e tij përfundimtare, përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se i konteston përgjigjet në padi të të paditurave, dhe po ashtu e konteston faktin se policia e sigurimit nuk i mbulon vetëm dëmet që automjeti i siguruar i' a shkaktonte palës së tretë vetëm gjatë fazës së lëvizjes, por edhe kur është e ndalur, e që lëndimet vijnë si rezultat i pjesës së ndarë organike të veturës apo gjësendeve që mund të jenë në rimorkion e veturës, e që bien nga vetura. Ka shtuar se pompa e cila ka shkaktuar dëmin tek paditësi nuk është e montuar në kamion por është mjet i veçantë i cili është i siguruar me policë të sigurimit tek e paditura e parë, dhe në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me mjet të montuar në makinë, por pompa është pjesë e makinës të siguruar me policë të sigurimit. Ka shtuar se automjeti me të cilin është shkaktuar dëmi është auto pompë betoni, e cila në momentin e shkaktimit të dëmit të paditësit ka qenë e siguruar me policën e sigurimit të auto përgjegjësisë tek e paditura e parë, çka sipas dispozitave ligjore, përkatësisht rregulli 3 mbi ndryshimin e rregullit për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë të lëshuar nga autoriteti qendror bankar – tani BQK- e cila në nenin 1.5 të këtij rregulli përcakton saktë se dëmi i shkaktuar nga përdorimi i automjetit nënkupton edhe dëmet e shkaktuar ndaj palës së tretë nga objektet që bien nga automjeti apo rimorkio. Ka shtuar tutje se, pompa e cila e ka shkaktuar dëmin tek paditësi nuk është e montuar por është pjesë integrale, dhe si e tillë edhe është e siguruar dhe ky fakt është provuar me provat e administruara. I ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit ta aprovojë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

E paditura e parë “...”, në përgjigje në padi ka kontestuar në tërësi bazën juridike të kërkesëpadisë, me arsyetimin se të paditurës së parë “...” i mungon legjitimiteti pasiv, për faktin se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me aksident komunikacioni, por me incident (fatkeqësi në punë). Tutje ka shtuar se në bazë të deklaratave të NPT G.A.P dhe deklaratave të punëtorëve të tjerë, të cilët ishin duke punuar rezultoi se deri tek incidenti ka ardhur nga një defekt në auto pompë ku është këputur një krah i saj dhe si pasojë e këputjes së krahut të auto pompës është lënduar paditësi i cili ka qenë nën pompë. Ka shtuar se vinçi i cili ka qenë i siguruar tek e paditura e parë nuk ka qenë në lëvizje, dhe nuk ka asnjë kontribut në incident. Ka theksuar se në bazë të dispozitave ligjore është paraparë që përgjegjësia mbi mbajtësin e policës së sigurimit, bie vetëm atëherë kur shkaktohet aksident komunikacioni dhe automjeti i siguruar është në lëvizje, mirëpo në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me aksident komunikacioni, por me incident në punë dhe në raste të tilla përgjegjësia objektive bie mbi punëdhënësin që punonjësin e saj ta kompensojë nga baza e përgjegjësisë objektive pasi që kemi të bëjmë me lëndim në punë.

Në seanca gjyqësore, përfaqësuesi i të paditurës së parë ka deklaruar: se për të paditurën e parë është kontestuese baza juridike e padisë me arsyetimin se në policën e sigurimit të lëshuar për automjetin – auto pompën është e qartë se automjeti është transportues dhe i cili është i siguruar për përdorim personal. Ka shtuar se, dëmi është shkaktuar nga pompa për hedhjen e betonit e

cila nuk është pjesë përbërëse e automjetit, por është pjesë lëvizëse dhe montuese e cila mund të montohet në secilin automjet transportues, dhe pasi që dëmi nuk është shkaktuar nga automjeti transportues – kamion i siguruar te e paditura e parë – por është shkaktuar nga pompa e betonit e cila ka qenë në pronësi të të paditurës së dytë, dhe e paditura e parë nuk ka asnjë përgjegjësi në këtë rast. Ka shtuar se po ashtu sipas deklaratave të punëtorëve me shkrim, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, auto pompa ka pasur defekte para se të ndodhë incidenti, dhe se sipas rregullit 3 të BQK-së dhe sipas Ligjit mbi autopërgjegjësisë, konkretisht neni 14, par. 1, pika 5, kompania e sigurimeve nuk mbulon defektet teknike apo avaritë e ndryshme në mjetin motorik. Ka theksuar se, incidenti ka ndodhur në vend punishte dhe asnjë automjet nuk ka qenë në lëvizje, si dhe sipas provave ka qenë i ngritur nga toka. Ka theksuar se në këtë situatë polica e sigurimit mbulon vetëm dëmet të cilat vijnë si pasojë e aksidentit dhe aplikohen vetëm nëse automjeti është në lëvizje.

Përfaqësuesi i të paditurës së dytë NPN “...”, në përgjigje në padi ka deklaruar, se e kontestojnë kërkesë padinë e paditësit, pasi që kërkesëpadija në raport me të paditurën e dytë është në tërësi e pabazuar, kjo për faktin se paditësi ka qenë punëtor i NPN G.A.P, e cila ndërmartje në bazë të Kontratës me NPN “...” – këtu të paditurën e dytë – ka kryer punët në ndërtimin e objektit të dytë në projektin “...”, në lagjen “...” në Prishtinë. Ka shtuar se ditën kritike, për betonimin e pllakës mbi katin e parë, furnizimin me beton e ka bërë e paditura e dytë “...” por për interes të NPN G.A.P, si kontraktues për ndërtimin e objektit. Ka shtuar në përgjigje në padi se e paditura e dytë nuk mban përgjegjësi sipas këtij rasti konkret, për kompensimin e dëmit pasi që as me veprim e as me mos veprim nuk e ka shkaktuar fatkeqësinë në të cilën është lënduar paditësi. Ka theksuar se auto pompa ka qenë teknikisht në rregull, para fillimit të funksionimit të saj është kontrolluar dhe është konstatuar se ajo ka qenë në gjendje të rregullt, dhe se auto pompës në momentin kritik papritmas i është këputur një krah i saj. Ka theksuar se këputja ka ndodhur jashtë mekanizmave ku mund të ndodhin defekte si në pjesët e lakimeve mekanike, dhe se askush nuk ka mundur të pres që të këputet krahu i pompës, dhe duke pasur parasysh funksionimin e rregullt të gjithë sistemit të punës së saj. Ka theksuar se, auto pompa ka qenë e siguruar në mënyrë të rregullt tek kompania “...” i cili sigurim përfshinë edhe ditën kritike kur ka ndodhur ngjarja, dhe fakti se automjeti – auto pompa ka qenë pronë e të paditurës së dytë, nuk do të thotë se nga ky fakt rezulton edhe përgjegjësia për kompensim të dëmit ndaj paditësit.

Përfaqësuesi i të paditurës së dytë, në seanca të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar: se e konteston padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit së të pabazuar në raport me të paditurën e dytë, sepse auto pompa dhe kamioni janë pjesë unike përbërëse dhe jo të ndara dhe ekziston regjistrimi në librat e regjistrimit të automjeteve sipas librezës që është dorëzuar në këtë gjykatë. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se, nuk është kontestuese se paditësi ka pësuar lëndime e të cilat janë përshkruar edhe me ekspertiza mjekësore, mirëpo e paditura e dytë automjetin me të cilin është shkaktuar dëmi e ka pasur të siguruar tek e paditura e parë dhe bazuar në rregullin 3 mbi ndryshimin e rregullit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, është përcaktuar se sigurimi i detyrueshëm duhet të bëhet edhe për automjetet e punës. Ka shtuar se sipas ekspertizave është vërtetuar se, mekanizmi për shkarkimin e betonit është pjesë integrale e automjetit. Ka shtuar se sipas ekspertizës së makinerisë është provuar se auto pompa me të cilën

është shkaktuar dëmi ka qenë i siguruar dhe se edhe përkundër amortizimit ka mund të përdorët në vazhdimësi.

II. Vërtetimi i gjendjes faktike

Gjykata, bazuar në propozimet e palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit, dhe në këtë çështje juridike kontestimore ka administruar provat si në vijim: fletë lëshimi me numër të historisë 453 lëshuar nga QKUK – Klinika e Ortopedisë dhe traumatologjisë lokomotorë, deklarata e datës 01.06.2009 e nënshkruar nga A.D, deklarata e nënshkruar nga M.S, deklarata e nënshkruar nga I.H, deklarata e nënshkruar nga B.R, Kontrata e punës e datës 01.05.2007, ekspertiza mjekësore e datës 15.05.2015, ekspertiza mjekësore e mjekësisë së punës, datë 25.09. 2015, ekspertiza financiare e ekspertit financiar, datë 01.08.2016, kuponët fiskal të lëshuar nga Spitali Amerikan në Kosovë, datës 23.04.2015, fletë lëshimi i lëshuar nga enti i mjekësisë për terapi fizikale dhe rehabilitim, Banjë, Istog, datë 25.06.2009, dëftesat lëshuar nga ministria e shëndetësisë dhe atë me numër 0249479, 0042568 dhe e datës 31.08.2009, ekspertiza e makinerisë, datë 08.10.2021, ekspertiza e komunikacionit e datës 27.10.2021, ekspertiza nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë e datës 16.01.2022, polica e sigurimit, datë 19.08.2008.

Gjykata, pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në nenin 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim si: LPK), erdhi në përfundimin se padia e paditëses është pjesërisht e bazuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Nga provat e administruara si më lartë si dhe nga vet deklarimi i palëve ndërgjyqëse, rezulton se është fakt i pakontestueshëm se, paditësi me datë 11.04.2009, gjatë betonimit të pllakës së betonit në kompleksin ndërtimor të quajtur “...”, në lagjen “...”, ishte lënduar si pasojë e këputjes së krahut të pompës për hedhjen e betonit, dhe nga ky incident kishte pësuar lëndime trupore. Po ashtu nga provat e administruara dhe nga vetë deklaramet e palëve është i pakontestueshëm fakti se kamioni nga i cili ishte këputur krahu i pompës për hedhjen e betonit ishte në pronësinë e këtu të paditurës së dytë NPN “...”. E pa kontestueshme në mes të palëve ishte edhe fakti se kamioni nga i cili është shkaktuar dëmi – pra lëndimi i paditësit – ishte i siguruar tek e paditura e parë Kompania e Sigurimeve “...”.

Kontestuese në mes të palëve ishin faktet se, kush kishte përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit ndaj paditësit, në bazë të cilit lloj të përgjegjësisë ishte shkaktuar dëmi, a mbulohet dëmi i ndodhur në vendin e punës me policën e sigurimi të kamionit – auto pompës, dëmi i ndodhur a konsiderohet se është shkaktuar në aksident komunikacioni dhe kamioni – auto pompa a kishte ndonjë defekt teknik në momentin e incidentit në të cilin ishte lënduar paditësi.

Fillimisht, nga provat e administruara rezulton se paditësi kishte marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar me kompaninë NPN G.A.P , fakt ky i cili vërtetohet edhe sipas Kontratës së punës së datës 01.05.2007, dhe ishte caktuar në pozitën – vendin e punës latues. Ndonëse paditësi kishte marrëdhënie të punës me kompaninë NPN G., nga deklarimi i palëve në procedurë rezulton se, kompania NPN G., kishte kontraktuar kompaninë NPN “...”– këtu e paditura e

dytë – për furnizim me beton (fakt ky i pohuar edhe nga vetë e paditura e dytë, në përgjigje në padi).

Për të vërtetuar faktin se në momentin e shkakimit të aksidentit, kamioni nga i cili ishte shkaktuar dëmi gjegjësisht lëndimi i paditësit, a kishte defekte teknike, gjykata me propozimin e palëve ka bërë nxjerrjen e provës përmes ekspertizës së makinerisë, e punuar nga eksperti i makinerisë Q.A, i cili në mendimin dhe konstatimin në ekspertizën e tij nga lëmia e makinerisë ka konstatuar se, dëmtimi respektivisht shkëputja e krahut të auto pompës me targa “...” ka qenë momentale (pasi që nuk ka argumente që tregojnë se e njëjta ka qenë e dëmtuar), dhe këputja ka ndodhur si pasojë e lëvizjes poshtë – lartë dhe majtas – djathtas, duke qenë nën presion të vazhdueshëm gjatë shkarkimit të betonit dhe për shkak të gjendjes respektivisht amortizimit të pajisjes për 20 vite. Për të dhënë sqarime lidhur me ekspertizën e tij, gjykata ka ftuar ekspertin e makinerisë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, i cili përkitazi me ekspertizën e hartuar në seancë ka deklaruar se mekanizmi për shkarkimin e betonit është pjesë integrale e kamionit dhe nuk është pjesë e bashkëngjitur, dhe po ashtu ka deklaruar se auto pompa është automjet që përbën një tërësi e cila vihet në lëvizje përmes motorit të automjetit në të cilën është e vendosur për të kryer punë të caktuara, në këtë rast shkarkimin e betonit dhe se në rastin konkret, në ditën kritike pajisja ka qenë e ndezur, në funksion por jo edhe në lëvizje. Tutje ka shtuar se sa i përket kontrollit teknik të automjetit, pra faktit se a është kryer kontrolli teknik i kamionit, nga pronari i kamionit NPN “...” nuk i është ofruar asnjë provë.

Gjykata, për nevojat e vërtetimit të gjendjes faktike të këtij rasti, ekspertizën e makinerisë e konsideroj të besueshme, ngase eksperti ekspertizën e tij e ka hartuar në mënyrë profesionale, dhe ka dhënë përgjigje në të gjitha detyrat e përcaktuara sipas aktvendimit të gjykatës për nxjerrjen e provës me ekspertizë.

Me qëllim të vërtetimit të faktit nëse incidenti në të cilin është lënduar paditësi mund të kualifikohet si aksident komunikacioni, gjykata me propozimin e palëve, ka bërë nxjerrjen e provës përmes ekspertizës së komunikacionit, të cilën e ka hartuar eksperti i komunikacionit B.L, i cili në ekspertizën e hartuar ka dhënë konstatimin se, incidenti në vend punishten e ndërtimit të objektit “...” ka ardhur gjatë shkarkimit të betonit nga auto pompa e cila ka qenë instaluar në kamionin e markës: Iveco – Magirus, me targa “...”, me ç ‘rast gjatë shkarkimit të betonit – këputet njëri krah i mekanizmit të auto pompës dhe e godet paditësin i cili në ato momente ndodhet nën të, dhe ishte duke e mbajtur gypin për shpërndarjen e betonit. Eksperti i komunikacionit ka dhënë konstatimin se kamioni në momentin e ndodhjes së incidentit nuk ishte në lëvizje, andaj rasti nuk mund të kualifikohet si aksident komunikacioni.

Gjykata, për nevojat e vërtetimit të gjendjes faktike të këtij rasti, ekspertizën e komunikacionit e konsideroj të besueshme, ngase eksperti ekspertizën e tij e ka hartuar në mënyrë profesionale, dhe ka dhënë përgjigje në të gjitha detyrat e përcaktuara sipas aktvendimit të gjykatës për nxjerrjen e provës me ekspertizë.

Me propozimin e palëve, gjykata ka bërë edhe nxjerrjen e provës nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, e hartuar nga eksperti A.K, i cili në ekspertizën e tij ka konstatuar se, kompania

NPN “...” ka angazhuar punëtorin (manipuluesin e auto pompës) të punojë me pajisje e cila bie në kategorinë e pajisjeve me rrezikshmëri të lartë, pa pasur për të njëjtin asnjë dokument që tregon karakteristikat teknike të saj. Tutje eksperti ka konstatuar se kompania NPN “...” nuk ka dhënë dëshmi se disponon, për kohën kur ka ndodhur rasti me dokumentacionin e nevojshëm teknik për vlerësimin e rrezikshmërisë së vendeve të punës, elaboratin për masat e sigurisë dhe mbrojtjes në punë, udhëzimet për manipulim dhe mirëmbajtje të auto pompës si dokument i rëndësishëm së veçantë. Ka shtuar se e paditura e dytë ka angazhuar të manipulojë me auto pompë punëtorin B.R për të cilin nuk ka dhënë dëshmi se ka pasur përgatitje të nevojshme shkollore dhe aftësim plotësues profesional për të operuar me atë pajisje. Ka shtuar se NPN “...” nuk ka bërë trajnimin e punëtorit B.R nga siguria dhe mbrojtja në punë dhe ka angazhuar në punë pajisje shumë të vjetër (sipas policës së sigurimi 20 vite) pa kontrolluar detalisht gjendjen teknike të saj. Në ekspertizë po ashtu ka shtuar se kompania nuk ka evidencë të kontrollimeve teknike të auto pompës dhe të veprimeve për mirëmbajtje, të ndërmarra në kontinuitet konform rekomandimeve të prodhuesit të saj. Si përfundim, eksperti i mbrojtjes dhe sigurisë në punë ka konstatuar se, e tërë përgjegjësia për incidentin sa i përket fushës së mbrojtjes dhe sigurisë në punë i takon këtu të paditurës së dytë dhe paditësi nuk ka asnjë përgjegjësi ose kontribut në lëndimin e tij. Për të dhënë sqarime rreth ekspertizës së punuar Gjykata ka bërë dëgjimin e ekspertit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, dhe në seancë eksperti ka deklaruar se, meqenëse paditësi ka qenë punëtor i kompanisë NPN G., ndërsa kompania NPN “...” ka qenë e kontraktuar për furnizimin me beton, rezulton se këtu e paditura NPN “...” ka pasur përgjegjësi që sipas Kontratës së tyre të përbashkët të krijojë ambient të sigurtë për punë për punëtorin – këtu paditësin. Tutje ka shtuar se, eksperti i ka kërkuar nga e paditura e dytë NPN “...” dokumentet (duke përfshirë dokumentacionin teknik të auto pompës, dëshmitë për aftësimin e punëtorit – manovruesit të kamionit për manipulim me auto pompë) por që të njëjtat nuk i janë siguruar nga e paditura e dytë.

Gjykata, për nevojat e vërtetimit të gjendjes faktike të këtij rasti, ekspertizën e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, e konsideroj të besueshme, ngase eksperti ekspertizën e tij e ka hartuar në mënyrë profesionale, dhe ka dhënë përgjigje në të gjitha detyrat e përcaktuara sipas aktvendimit të gjykatës për nxjerrjen e provës me ekspertizë.

Me qëllim të përcaktimit të lëndimeve të pësuar nga paditësi me rastin e lëndimit, gjykata me propozimin e palëve ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë e cila është hartuar nga eksperti i ortopedisë Xh.S dhe eksperti i psikiatrisë Sh.M. Eksperti i ortopedisë në ekspertizën e tij ka konstatuar se paditësi me rastin e lëndimit ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë afërsisht tridhjetë minuta (duke llogaritur kohën e aksidentit, transportit, diagnostifikimit, deri në fillimin e trajtimit mjekësor), dhimbje fizike të intensitetit të rëndë për pesë ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm për pesëdhjetë e gjashtë ditë, dhimbje fizike të intensitetit të vogël, sipas të dhënave nga anamneza e marrur ka edhe në kohën e hartimit të ekspertizës, sidomos gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike, e që më të shprehura janë në gjurin e këmbës së djathtë dhe në formë dhimbjesh krah – qafë të dyanshme dhe bel – këmbë djathtas. Eksperti i ortopedisë po ashtu ka konstatuar se kufizimi i aftësisë për jetë tek paditësi është i shprehur dyzet e pesë % (45%), për shkak të humbjes së gishtit të parë të dorës së majtë, pika 114, artrozës deformuese të gjurit të

djathtë, e shoqëruar me deformime të boshtit me kahje mbrapa të këtij gjuri, në shkallë të mesme pika 199B, si dhe vrajave të thella të mëdha të kofshës së djathtë dhe dorës së majtë e shoqëruar me zvogëlim të vëllimit muskular të kofshës me perimetër 2,5 centimetër. Sa i përket shëmtimit trupor, eksperti i ortopedisë ka konstatuar se tek paditësi shëmtimi trupor është i shprehur në shkallë të mesme për shkak të vrajës në kofshën e djathtë në gjatësi prej 21x05 centimetër, vrajave të kunjit kockor në të anët e pjesës së sipërme të përparme të kërcirit të djathtë me perimetër 0,5x0,5 centimetër, vrajës tjetër me perimetër 1x1 centimetër në pjesën e brendshme të mbi gjurit të djathtë nga shpimi me armaturë, hypotrofisë muskulare të kofshës dhe vrajës në dorën e majtë në gjatësi prej 4centimetër si pasojë e amputimit të gishtit të madh. Sa i përket ndihmës së personit të tretë, eksperti ka konstatuar se, ndihma e personit të tretë ka qenë e domosdoshme në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh, duke llogaritur kohën e sanimit të thyerjes, nevojës për lëvizjen me kukëza dhe fillimit e rehabilitimit fizioterapeutik. Sa i përket nevojës për ushqim të përforcuar eksperti ka konstatuar se ka qenë i domosdoshëm në kohëzgjatje prej tetë muajsh, në kuptim të përzgjedhjes së ushqimit të pasur me proteina, albumina, minerale, karbohidrate dhe vitamina. Ndërsa sa i përket rehabilitimit fizioterapeutik dhe klimatik, eksperti i ortopedisë ka konstatuar se, ka qenë i domosdoshëm në kohëzgjatje prej tridhjetë ditësh për vitin e parë pas aksidentit si dhe prej njëzet ditësh për vitin e dytë pas aksidentit.

Ndërsa eksperti i psikiatrisë në ekspertizën e tij ka konstatuar se, paditësi në momentin e lëndimit ka përjetuar frikë primare të intensitetit posaçërisht të lartë deri në tre sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej njëzet minuta, frikë sekondare e intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej katër javë, dhe frikë sekondare e intensitetit të ulët në kohëzgjatje prej gjashtë muaj.

Po ashtu me propozimin e palëve, gjykata ka bërë edhe nxjerrjen e provës përmes ekspertizës nga lëmia e mjekësisë së punës, e hartuar nga eksperti Dr. K.Z, i cili në ekspertizën e hartuar, ka konstatuar se tek paditësi zvogëlimi i aftësisë punuese i shprehur në përqindje është 45%.

Gjykata ekspertizat mjekësore (ortopedisë, psikiatrisë dhe mjekësisë së punës) i konsideroj të besueshme, ngase të njëjtat ishin profesionale dhe brenda vëllimit të vendimit të Gjykatës për caktimin e tyre.

III. Baza ligjore

Nisur nga fakti se incidenti në të cilin paditësi është lënduar gjatë betonimit të pllakës së betonit, ka ndodhur me datë 11.04.2009, Gjykata vlerëson se ligj i aplikueshëm në kohën e ndodhjes së incidentit – lëndimit ishte Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i miratuar me datë 30 mars 1978 (në vijim të tekstit referuar si: LMD i vitit 1978), dhe rrjedhimisht gjendja faktike e vërtetuar si më lartë duhet të kualifikohet nën dispozitat e këtij ligji.

LMD i vitit 1978 në nenin 154 përcakton si në vijim: *Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i dëmi për ambientin përgjigjet pavarësisht nga faji. Për dëmin pavarësisht nga faji përgjigjet edhe në raste të tjera të*

parashikuara me ligj, ndërsa vet kuptimin i dëmit përkufizohet në nenin 155 të LMD-së, si në vijim: Dëmi është pakësim i mjeteve shoqërore, respektivisht i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe parandalimi i shtimit të tyre (përfitim i munguar), si dhe shkak i tjetrit të dhimbjës ose të frikës fizike apo psiqike (dëmi jomaterial).

Me nenin 173 të LMD-së së vitit 1978, përcaktohet: *Dëmi i lidhur me sendin e rrezikshëm, respektivisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send respektivisht nga kjo veprimtari me përjashtim në qoftë se provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit.*

Ndërsa me nenin 174 të LMD-së së vitit 1978 përcaktohet se: *Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të. Zotërues konsiderohet poseduesi i sendit, si dhe personi shoqëror juridik që ka të drejtë disponimi, respektivisht të drejtë shfrytëzimi të përkohshëm.*

Me nenin 177 të LMD-së së vitit 1978 përcaktohet se: *Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia në qoftë se provon se dëmi rrjedh nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit dhe efekti i të cilit nuk ka mundur parashihet dhe as të mënjanohet ose të evitohet. Zotëruesi i sendit lirohet nga përgjegjësia edhe në qoftë se provon se dëmi ka lindur vetem nga veprimi i dëmtuesit ose i personit të tretë gjë të cilën ai nuk ka mundur të parashihte dhe pasojat e të cilit nuk ka mundur ti shmangë, ose t'i lejojë. Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia pjesërisht në qoftë se dëmtuesi pjesërisht i ka kontribuar në lindjen e dëmit. Në qoftë se në lindjen e dëmit ka kontribuar pjesërisht personi i tretë ky i përgjigjet dëmtuesit solidarisht bashkë me zotësuesin e sendit, ndërsa e ka për detyrë të përballojë kompensimin përpjestimisht me peshën e fajit të vet. Personi me të cilin zotëruesi është shërbyer gjatë përdorimit të sendit nuk konsiderohet si person i tretë.*

IV. Vlerësimi meritor i Gjykatës

Gjykata konsideron se fillimisht duhet të sqarohet baza e kërkesëpadisë dhe baza e përgjegjësisë së të paditurës së dytë në shkaktimin e dëmit ndaj paditësit. Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se, e paditura e dytë është kompani e cila si aktivitet të saj tregtar/biznesor në kohën e ndodhjes së lëndimit të paditësit, ndër të tjera kishte edhe furnizimin me beton, furnizim ky të cilin e paditura e dytë e kishte bërë me porosinë e një kompanie tjetër të quajtur NPN G.A.P. Në këtë kuptim, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, transportimi dhe shkarkimi i betonit me mjete të veçanta për këtë destinim, paraqet veprimtari të rrezikshme, kjo për faktin se aktiviteti i tillë kërkon pajisje të veçanta si dhe kualifikim të veçantë të punëtorëve për kryerjen e veprimeve për këtë veprimtari. Gjykata vlerëson se përcaktimi se çka konsiderohet veprimtari e rrezikshme dhe send i rrezikshëm nuk përcaktohet me dispozita ligjore, mirëpo kjo duhet të konstatohet nga gjykata në secilin rast veç e veç, andaj në rastin e gjykuar me këtë aktgjykim, gjykata konsideron se, operimi me automjete të karakterit të veçantë siç janë kamionët dhe auto pompa për shkarkimin e betonit, përmbajnë një kuantum të shtuar të rrezikut i cili mund të rrjedhë nga ky send, andaj mbi bazën e kësaj, gjykata vlerëson se kamioni për shkarkimin e betonit nga i cili ishte lënduar paditësi, në kohën e operimit të tij sipas destinimit (pra gjatë shkarkimit të betonit) paraqet send të rrezikshëm, ndërsa vet veprimtaria e transportimit dhe shkarkimit të betonit paraqet veprimtari

të rrezikshme. Në këtë kuptim, meqenëse kamioni për shkarkimin e betonit, nga i cili është lënduar paditësi paraqet send të rrezikshëm, atëherë rezulton se në këtë situatë duhet të zbatohen rregullat e përgjegjësisë objektive – përgjegjësisë pa faj.

Në rastet kur për dëmin e shkaktuar zbatohen rregullat e përgjegjësisë objektive, gjykata vlerëson se bazuar në nenin 177 paragrafi 1 të LMD-së së vitit 1978, pronari i sendit të rrezikshëm lirohet nga përgjegjësia vetëm në rast se provohet se, *dëmi rrjedh nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit dhe efekti i të cilit nuk ka mundur parashihet dhe as të mënjanohet ose të evitohet*. Sipas interpretimit të nenit 177 par 1 të LMD-së, për tu liruar nga përgjegjësia, pronari i sendit të rrezikshëm duhet të provojë në procedurë gjyqësore se: a) dëmi ka rrjedhur nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit dhe b) efekti i të cilit nuk ka mund të parashihet as të parandalohet, dhe si rrjedhojë nga dispozita në fjalë rezulton se këto kushte duhet të përmbushen në mënyrë kumulative.

Sa i përket kauzalitetit dhe barrës së të provuarit, sipas nenit 173 të LMD-së së vitit 1978, përcaktohet se dëmi që shkaktohet lidhur me sendin e rrezikshëm, konsiderohet se rrjedh nga ai send. Në bazë të këtyre dispozitave dhe këtij interpretimi, gjykata vlerëson se në rastet kur dëmi rrjedh nga sendi i rrezikshëm, barra e të provuarit se dëmi nuk ka ndodhur për shkak të sendit të rrezikshëm, bie tek subjekti që e ka nën posedim ose është përgjegjës për menagjimin e sendit të rrezikshëm (në rastin e gjykuar me këtë aktgjykim e paditura e dytë). Deri tek ky vlerësim Gjukata vije duke u bazuar në normën e nenit 173 të LMD-së së vitit 1978 që përcakton: *“Dëmi i lidhur me sendin e rrezikshëm, respektivisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send respektivisht nga kjo veprimtari me përjashtim në qoftë se provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit”*.

Në këtë kuptim, kjo gjykatë vlerëson se në rastin e gjykuar me këtë aktgjykim, përmes provave të administruara në shqyrtim gjyqësor, paditësi ka arritur të provojë faktet vendimtare, se të njëjtit i është shkaktuar dëm, dhe se dëmi ka rrjedhur nga veprimtaria e rrezikshme. Kjo për faktin se përgjatë shqyrtimit gjyqësor ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese se paditësi është lënduar nga kamioni – auto pompa e cila ka qenë në pronësi të të paditurës së dytë. Po ashtu bazuar në provat e nxjerra përmes ekspertizave mjekësore, janë vërtetuar shkallët e lëndimeve të paditësit nga incidenti i ndodhur – respektivisht nga lëndimi si pasojë e këputjes së krahut të auto pompës.

Sa i përket të paditurës së dytë, Gjukata vlerëson se, sipas provave të administruara nuk është provuar se këputja e krahut të auto pompës për shkarkimin e betonit të ketë ndodhur nga ndonjë faktor i jashtëm. Për më tepër, nga ekspertiza e makinerisë dhe ekspertiza e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, është provuar se kamioni në pronësinë e të paditurës së dytë – pjesë e të cilit ishte auto pompa për shkarkimin e betonit – ishte e vjetër njëzet vite, andaj edhe mundësia e shkaktimit të dëmit me anë të përdorimit të kamionit – auto pompës sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të duhej të ishte e parashikueshme. Në këtë kuptim, Gjukata sjell në vëmendje se sipas nenit 177 të LMD, e paditura e dytë do të lirohej nga përgjegjësia objektive vetëm në rast se do të vërtetoheshin në mënyrë kumulative dy kushtet, se dëmi ka rrjedhur nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit dhe që i njëjti dëm nuk ka mundur të parashikohej ose të parandalohet. Po

ashtu, ndonëse eksperti i makinerisë në ekspertizën e tij ka konstatuar se këputja e krahut të auto pompës ka qenë e rastësishme dhe për shkak të manovrimit lartë – poshtë dhe majtas – djathtas, dhe po ashtu pavarësisht faktit se eksperti i makinerisë ka konstatuar se kamioni – auto pompa ka qenë e përshtatshme për përdorim në gjendjen në të cilën ishte, Gjykata vlerëson se në rastet e përgjegjësive objektive, pronari i mjetit të rrezikshëm, në këtë rast e paditura e dytë nuk mund të lirohet nga përgjegjësia, ngase përgjegjësia për kompensimin e dëmit në raste të tilla derivon nga vet fakti se e paditura e dytë është pronare e sendit të rrezikshëm dhe operon me të njëjtin, dhe lirimi nga përgjegjësia për kompensimin e dëmit mund të vije në shprehje vetëm në rast se provohen dy kushtet e lartë cituara se dëmi ka rrjedhur nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit dhe që i njëjti dëm nuk ka mundur të parashikohej ose të parandalohet.

V. Lartësia e shpërblimit të dëmit

Meqenëse sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë, gjykata ka caktuar shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, kjo duke u bazuar edhe në ekspertizat mjekësore.

Sa i përket shumave të shpërblimit të dëmit jo material, ekspertiza e ortopedisë ka përcaktuar se, paditësi nga lëndimi ka pasur dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë afërsisht tridhjetë minuta (duke llogaritur kohën e aksidentit, transportit, diagnostifikimit, deri në fillimin e trajtimit mjekësor), dhimbje fizike të intensitetit të rëndë për pesë ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm për pesëdhjetë e gjashtë ditë, dhimbje fizike të intensitetit të vogël, sipas të dhënave nga anamneza e marrur ka edhe në kohën e hartimit të ekspertizës, sidomos gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike, andaj bazuar në këto konstatime të ekspertit të ortopedisë gjykata për dhimbje fizike caktoj shumën e kompensimit prej 8,000.00 euro. Sa i përket kompensimit për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, eksperti i ortopedisë po ashtu ka konstatuar se kufizimi i aftësisë për jetë tek paditësi është i shprehur dyzet e pesë përqind (45%), për shkak të humbjes së gishtit të parë të dorës së majtë, pika 114, artrozës deformuese të gjurit të djathtë, e shoqëruar me deformime të boshtit me kahje mbrapa të këtij gjuri, në shkallë të mesme pika 199B, si dhe vrajave të thella të mëdha të kofshës së djathtë dhe dorës së majtë e shoqëruar me zvogëlim të vëllimit muskular të kofshës me perimetër 2,5 centimetër, andaj bazuar në këto konstatime të ekspertit gjykata caktoj shumën e kompensimit në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shumën prej 20,000.00 euro. Sa i përket shëmtimit trupor, eksperti i ortopedisë ka konstatuar se tek paditësi shëmtimi trupor është i shprehur në shkallë të mesme për shkak të vrajës në kofshën e djathtë në gjatësi prej 21x05 centimetër, vrajave të kunjit kockor në të anët e pjesës së sipërme të përparme të kërcirit të djathtë me perimetër 0,5x0,5 centimetër, vrajës tjetër me perimetër 1x1 centimetër në pjesën e brendshme të mbi gjurit të djathtë nga shpimi me armaturë, hypotrofisë muskulare të kofshës dhe vrajës në dorën e majtë në gjatësi prej 4centimetër si pasojë e amputimit të gishtit të madh, andaj bazuar në këto konstatime gjykata ka caktuar shumën e kompensimit për të vuajtje shpirtërore për shëmtim trupor prej 3,500.00 euro. Ndërsa sa i përket kompensimit të dëmit jo material në emër të frikës së përjetuar, eksperti i psikiatrisë në ekspertizën e tij ka konstatuar se, paditësi në momentin e lëndimit ka përjetuar frikë primar të intensitetit posaçërisht të lartë deri në tre sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej njëzet minuta,

frikë sekondare e intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej katër javë, dhe frikë sekondare e intensitetit të ulët në kohëzgjatje prej gjashtë muaj, andaj gjykata në emër të frikës caktoj shumën e kompensimit prej 6,500.00 euro. Caktimin e shumave të kompensimit të dëmit jo material gjykata e ka bërë duke u bazuar në dispozitën e nenit 200 të LMD-së së vitit 1978, i cili përcakton: *Për dhimbjet e pësura fizike, për dhimbjet e pësura shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërbën ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, shumat e caktuara në emër të kompensimit të dëmit jo material janë adekuate duke pasur parasysh të mirën e shkelur dhe qëllimin e kompensimit të dëmit jo material, i cili në asnjë situatë nuk ka për qëllim pasurimin e të dëmtuarit – këtu paditësit – por satisfaksionin moral të paditësit për dëmtimet - lëndimet e pësura.*

Ndërsa sa i përket shumave të kompensimit të dëmit material, gjykata ka caktuar shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar po ashtu në ekspertizat mjekësore dhe asaj financiare. Sa i përket ndihmës së personit të tretë, eksperti ka konstatuar se, ndihma e personit të tretë ka qenë e domosdoshme në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh, duke llogaritur kohën e sanimit të thyerjes, nevojës për lëvizjen me kukëza dhe fillimit e rehabilitim fizioterapeutik, andaj gjykata ka caktuar shumat e kompensimi nga kjo bazë prej 1,800.00 euro (duke llogaritur shumën prej 10 – dhjetë euro në ditë). Sa i përket nevojës për ushqim të përforcuar eksperti ka konstatuar se ka qenë i domosdoshëm në kohëzgjatje prej tetë muajsh, në kuptim të përzgjedhjes së ushqimit të pasur me proteina, albumina, minerale, karbohidrate dhe vitamina, andaj gjykata ka caktuar shumat e kompensimi nga kjo bazë prej 2,000.00 euro (duke llogaritur shumën prej 10 euro në dite, dhe duke vendosur brenda kufijve të kërkesave të paraqitura nga pala paditëse). Gjykata për kategoritë e dëmit ushqim i përforcuar dhe ndihmë dhe kujdes i huaj, vlerëson se mund të caktohet edhe në mungesë të provave materiale, ngase është standard i ndërtuar tashmë nga praktika gjyqësore, dhe vështirë i argumentuar. Andaj pas analizimit të të gjitha provave ka ardhur në përfundim se shumat e gjykuara të shpërblimit të dëmit për këto kërkesa janë në përputhje me dëmin e pësuar sipas këtyre bazave. Gjithashtu, gjykata vë në dukje se për këto dy kategori të dëmit për paditësin, është vendosur brenda kufijve të kërkesëpadisë, duke aplikuar nenin 2 paragrafi 1 të LPK-së, sipas të cilit *Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse*, ndonëse paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihme dhe kujdes nga personi i tretë për periudhë më të gjatë kohore.

Sa i përket rentës, gjykata ka caktuar shumat në formë të rentës së arritur për pagesë dhe të rentës së ardhme të papaguar. Shumën e rentës së arritur për pagesë gjykata e ka caktuar në shumën prej 16,165.50 euro, kjo duke u bazuar në ekspertizën e hartuar nga eksperti financiar, A.B, i cili në ekspertizën e tij ka caktuar se shumat e rentës së arritur për pagesë deri në kohën

e hartimit të ekspertizës (datë: 31.07.2016) është shuma prej 16,165.50 euro. Ndërsa sa i përket rentës së ardhme, gjykata ka caktuar obligimin e të paditurës së dytë që të paguajë shumën prej 100 euro në muaj, po ashtu duke u bazuar në ekspertizën financiare të hartuar nga eksperti i lëmisë financiare, i cili në ekspertizën e tij ka llogaritur se shuma e fitimit të humbur të cilën do ta realizonte paditësi, duke marrë për bazë nivelin e shkollimit të tij, shkallën e zvogëlimit të aftësisë së tij për punë, është shuma prej 100 euro në muaj. Caktimin e shumave si më lartë, në emër të dëmit material në formë të rentës, gjykata e ka bërë duke u bazuar në nenin 172, paragrafi 1 the 2 të LMD-së së vitit 1978, i cili përcakton se: *Në rast të vdekjes të lezionimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit kompensimi caktohet si rregull në formë të rentës në të holla për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar. Renta në të holla e gjykuar për efekt të kompensimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diçka tjetër.*

VI. Pjesa e refuzuar e kërkesëpadisë

Fillimisht sa i përket shumave të refuzuara në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata ka refuzuar shumat: për dhimbje trupore - fizike, shumën prej 2,000.00 euro, për frikën e pësuar, shumën prej 1,500.00 euro, për shëmtim trupor, shumën prej 3,500.00 euro, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 10,000.00, për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej 200,00 euro, në emër të rentës së arritur shumën prej 2,657.1 euro, ndërsa në tërësi shumën prej 1.100,00 euro të kërkuar në emër të rehabilitimit fizioterapeutik dhe klimatik. Kjo për faktin se aprovimi i shumave më të larta se sa ato në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, sipas vlerësimit të kësaj gjykate do to ishin të larta dhe në kundërshtim me qëllimin e kompensimit të dëmit jo material, i cili ka për qëllim satisfaksionin e paditësit për shkak të lëndimeve të pësuar (kjo duke u bazuar edhe në udhëzimin e Gjykatës Supreme nr. 41/2023, të datës 07.02.2023).

Sa i përket rehabilitimit fizioterapeutik dhe klimatik, gjykata ka refuzuar në tërësi shumën e kërkuar nga paditësi, kjo për faktin se paditësi gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka ofruar asnjë faturë ose kupon fiskal për të argumentuar faktin se i njëjti me qëllim të trajtimit fizioterapeutik ka kryer pagesa për këtë qëllim pranë ndonjë institucioni shëndetësor.

Ndërsa sa i përket rentës së arritur për pagesë, gjykata ka refuzuar shumën prej 2,657.1 euro, kjo për faktin se nga ekspertiza financiare, eksperti ka llogaritur se, shuma e arritur për pagesë në emër të rentës deri në kohën e hartimit të ekspertizës, është shuma prej: 16,165.50, ndërsa shuma prej 2,657.10 eksperti e ka llogaritur në emër të kamatës e cila ka rrjedhur për shumën e rentës së arritur, dhe kamata nga eksperti është llogaritur në shkallën prej 3,5%, ndërsa sipas vlerësimit të gjykatës kamata në rentën e arritur duhet të llogaritet si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, siç edhe është njohur me vendim të gjykatës, andaj gjykata ka refuzuar pjesën e kërkuar në emër të kamatës për rentën e arritur, ngase eksperti financiar shumën e kamatë e ka llogaritur jashtë vëllimit të aktvendimit të Gjykatës, dhe Gjykata kamatën e ka gjykuar në shkallë – lartësi dhe periudhë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pikës III të këtij aktgjykimi, gjykata ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit në raport me të paditurën e parë Kompania e Sigurimeve “....”, kjo për faktin se nuk është

provuar se e paditura e parë ka përgjegjësi për kompensimin e dëmit paditësit. Nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, është provuar se kamioni – auto pompa pronë e të paditurës së dytë ishte e siguruar tek e paditura e parë – kompania e sigurimeve “...”, megjithatë sipas vlerësimit të gjykatës polica e sigurimit e datës 19.08.2008 mbulonte dëmet e shkaktuara në aksident komunikacioni, ndërsa në rastin konkret, nga të gjitha provat e administruara, por edhe nga vet deklaratimet e palëve në seancat e shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se paditësi ishte lënduar në vend punishteve të objektit të quajtur “...”, dhe se në momentin e këputjes së krahut të auto pompës, kamioni ishte i ndalur dhe ishte duke u kryer veprimi i shkarkimit të betonit. Në këtë kuptim, siç është theksuar edhe më lartë, gjykata me propozimin e palëve ka caktuar ekspertizën e komunikacionit, dhe eksperti i komunikacionit ka dhënë konstatimin se rasti i lëndimit të paditësit nuk mund të kualifikohet si aksident komunikacioni. Bazuar në kohën e ndodhjes së lëndimit në punë, gjykata gjen se e drejtë materiale e zbatueshme në fushën e sigurimit të autopërgjegjësive, ishte Rregulla 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësive, e miratuar nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës me datë 1 tetor 2008. Me nenin 1 paragrafi 4, nën paragrafi 2 parashihet: *Sigurimi i auto përgjegjësive është i detyrueshëm për pronarët dhe shfrytëzuesit e automjeteve të destinuara për transportin e personave dhe mallrave, rimorkiove, automjeteve të punës dhe traktorëve, të cilët sipas dispozitave për regjistrimin e automjeteve duhet të marrin licencën (lejen e qarkullimit) për trafik. Ky sigurim nuk është i detyruar për KFOR-in*, ndërsa paragrafi 4, nën paragrafi 4 i nenit 1 të kësaj rregulloreje, parashihet që: *Sigurimi i autopërgjegjësive kontrahohet për periudhën kohore minimale të mbulesës një (1) vit para se automjeti të hyjë në trafik dhe duhet të ripërtërihet për kohën derisa automjeti të shfrytëzohet. Sidoqoftë, në rast të bartjes së pronësisë së automjetit, kontrata mbi sigurimin e detyrueshëm të auto përgjegjësive mund të jetë për një periudhë më të shkurtër se një (1) vit, në mënyrë që të përputhet me datën e skadimit të regjistrimit të automjetit*, ndërsa me paragrafin 5 të nenit 1 të kësaj rregulloreje parashihet: *Pronari apo shfrytëzuesi i regjistruar i automjetit dhe rimorkios është i detyruar të kontrahojë sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësive nga detyrimet për dëmet e shkaktuara palëve të treta që si kanë pasojë vdekjen, lëndimin trupor, dëmtimin e shëndetit apo dëmtimin ose shkatërrimin në lidhje me shfrytëzimin e automjetit motorik*. Nga interpretimi i këtyre dispozitave të rregullores në fuqi që rregullonte fushën e sigurimeve të autopërgjegjësive në kohën e lëndimit të paditësit, vihet në përfundim se polica e sigurimit ishte e detyrueshme për të gjitha automjetet para se të njëjtat të fillojnë të lëvizin në trafik, kjo edhe për faktin se në nenin 1 të kësaj rregullore ishte përcaktuar se, qëllimi i rregullores ishte që të mbulohehin dëmet e shkaktuara nga auto përgjegjësia, pra nga drejtimi i automjetit. Bazuar në këto konstatime gjykata vlerëson se polica e sigurimit e kontraktuar ndërmjet të paditurës së parë dhe të paditurës së dytë nuk mbulon edhe dëmet e shkaktuara nga automjeti në vend punishteve, gjatë shkarkimit të betonit me qëllim të betonimit të pllakës së objektit “...”, kjo për faktin se sigurimi i vend punishteve kërkon lloj të veçantë të policës së sigurimit, andaj përderisa me Kontratën për sigurimin nuk është përcaktuar se mbulohej edhe dëmet e shkaktuara si pasojë e përdorimit të automjetit jashtë komunikacionit, atëherë nuk mund të konkludohet se polica e sigurimit e kontraktuar në mes të të paditurës së parë dhe të paditurës së dytë të mbulojë edhe dëmin e ndodhur ndaj paditësit në vend punishteve. Ndërsa fakti se lëndimi i paditësit ka ndodhur në vend punishteve, dhe se kamioni nga i cili është shkaktuar lëndimi nuk ka qenë duke lëvizur

nuk ka qenë kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse, e që po ashtu është konstatuar edhe nga eksperti i makinerisë dhe eksperti i komunikacionit.

Në funksion të kësaj, Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e përfaqësuesit të të paditurës së dytë, të paraqitura në fjalën përfundimtare, ku ka deklaruar se sipas nenit 1.4 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullit 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë, sigurimi i autopërgjegjësisë ka qenë i detyrueshëm edhe për *automjetet e punës*, megjithatë sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, kjo dispozitë i referohet sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësisë për automjetet e punës, por gjatë kohës sa të njëjtat janë në lëvizje në komunikacion, për faktin se meqenëse edhe automjetet e punës lëvizin në trafik, sipas rregullores në fuqi është paraparë edhe sigurimi i detyrueshëm i të njëjtave me qëllim të mbulimit të dëmeve eventuale që mund të i' u shkaktojnë palëve të treta, megjithatë kjo nuk nënkupton se polica e sigurimit të detyrueshëm ka mbuluar edhe të gjitha dëmet që mund të i' u shkaktohen palëve të treta gjatë shkarkimit të betonit në vend punishte, ngase një mbulesë e dëmeve të tilla nuk është përcaktuar shprehimisht në asnjë dispozitë të Rregullit 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë, por as në vet policën e sigurimit të datës 19.08.2008.

VII. Kamata dhe shpenzimet e procedurës.

Sa i përket kamatës, gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, ashtu që ka obliguar të paditurën e dytë që shumat e aprovuara me këtë aktgjykim, t'ia paguajë me kamatë ligjore, dhe atë si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit pa destinim të caktuar, kjo për faktin se sipas vlerësimit të kësaj gjykate shkalla e kamatës për dëmet që kanë ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në fuqi LMD-i vitit 1978 llogaritet si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim, ndërsa vetëm sa i përket kërkesave periodike të rentës së arritur për pagesë, për ato kërkesa që kanë arritur për pagesë pas datës 19.12.2012, është gjykuar shkalla e kamatës prej 8% në vit, kjo duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së i cili përcakton: *1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.* Ndërsa sa i përket kohës së llogaritjes së kamatës, në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi është gjykuar se kamata për shumat e aprovuara në emër të dëmit jo material fillon të llogaritet nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, ndërsa kamata në shumat e aprovuara në emër të dëmit material fillon të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë (sa i përket lartësisë së kamatës dhe periudhës se kur fillon të llogaritet, gjykata u bazua edhe në mendimin juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, i dt.02.12.2020).

Sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, gjykata në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore ka obliguar të paditurën e dytë që paditësit t'ia paguajë shumën prej 5,430.00 euro, dhe atë duke llogaritur shpenzimet e krijuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 312,00 euro, në emër të precizimit të kërkesëpadisë shumën prej 312 euro (për faktin se paditësi nuk ka mundur të paraqet shumat e sakta pa nxjerrjen e provave përmes ekspertizave përkatëse), në emër të përfaqësimit në seanca shumën prej 4,056.00 euro (15 seanca, secila në shumën prej 270,4 euro), në emër të shpenzimeve të

ekspertizave shumë prej 750 euro. Gjykata ka refuzuar pjesën tjetër të kërkuar të shpenzimeve të procedurës, kjo për faktin se paditësi shpenzimet për një seancë i ka kërkuar në shumë prej 405.60 euro, ndërsa bazuar në rregulloren për tarifa të avokatëve, kompensimi për një seancë për kontestet mbi vlerën dhjetë mijë euro është 270,40 euro, kjo për faktin se përfaqësimi është kryer vetëm për një paditës.

Bazuar në të lartë cekurat, në bazë të nenit 160 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.2483/2020, datë 10.01.2024

**Gjyqtari,
Florian Krasniqi**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.